

Statistikat e Bujqësisë 2024

Tiranë, më 23 Qershor 2025: Në vitin 2024, prodhimi bujqësor në vend ka shënuar zhvillime të rëndësishme në disa kultura kryesore:

- Drithërat arritën në 649.919 tonë, me nivelin më të lartë të prodhimit në Qarkun Fier me 149.252 tonë, ndjekur nga Elbasani dhe Korça.
- Perimet regjistruan një prodhim prej 1.424.404 tonë, me rritje 2,9 %, krahasuar me një vit më parë. Fieri, Tirana dhe Berati janë qarqet me prodhimin më të lartë.
- Patajtja shënoi rritje me 1,3 %, duke arritur në 277.824 tonë, ku qarku Korçë kryeson.
- Fasulet dhe bimët medicinale shënuan rritje përkatësisht me 4,6 % dhe 7,7 %, ndërsa bimët industriale pësuan rënie me 7,9 %.

Prodhimi në serra

- Prodhimi në serra përfaqëson 22,7 % të perimeve gjithsej, me një rritje vjetore 4,0 %.
- Qarku Fier kontribuon me 49,1 % dhe Berati me 30,2 % të këtij prodhimi.

Struktura e perimeve

- Perimet e njoma përbëjnë 66,1 % të prodhimit total, ku domatja, kastraveci dhe speci janë më të përfaqësuarat.
- Brenda perimeve të thata dhe bostanoreve dominojnë përkatësisht qepa e thatë me 83,9 % dhe shalqini me 80,2 %.

Drufëtorët

- Prodhimi i pemëve frutore arriti në 295.532 tonë, duke shënuar rritje prej 3,1 %, me Qarkun Korçë si kontribuesin kryesor.
- Në pemët me farë, molla ka peshën më të madhe, ndërsa në pemët me bërthamë dominojnë kumbullat.
- Prodhimi i ullirit arriti në 146.726 tonë, duke shënuar një rritje prej 24,6 %, krahasuar me një vit më parë.
- Qarku Vlorë është kontribuesi kryesor në prodhimin e agrumeve me 62,6 %, ndaj prodhimit gjithsej në vend, 59.162 tonë.

Për më shumë informacion dhe për të parë tabelat e detajuara, vizitoni bazën e të dhënave në faqen zyrtare të INSTAT: [Statistikat e Bujqësisë](#)

Për publikim 23/06/2025

Metodologjia

Statistikat e bujqësisë për vitin 2024 mbështeten në informacionin administrativ, të mbledhur nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Baza ligjore për mbledhjen e statistikave bujqësore është Ligji Nr. 17/2018 për Statistikat Zyrtare dhe Ligji Nr. 30/2022 i Statistikave Zyrtare 2022-2026, gjithashtu duke zbatuar klasifikimet dhe përkufizimet sipas rregulloreve Evropiane përkatëse -Rregullorja Evropiane (KE) Nr. 543/2009 mbi Statistikat e Bujqësisë.

Informacioni mblidhet në terren nga specialistët e ekstensionit në të gjithë vendin. Këta specialistë mbledhin të dhëna drejtpërdrejt nga fermerët. Prodhimi bujqësor është sinonim me prodhimin e vjelë dhe përfshin sasi të shitura, konsumin direkt në familjet fermere, humbjet dhe mbetjet në fermë, si dhe humbjet gjatë transportit, ruajtjes dhe paketimit.

Statistikat e bimëve i referohen të dhënave vjetore si: sipërfaqe e kultivuar, sipërfaqe prodhuese për drufrutorët, prodhim dhe rendiment.

Përkufizime

Viti i prodhimit

Me vit prodhim i nënkuptojmë vitin kalendarik në të cilin fillon vjelja e prodhimit.

Klasifikimi

Klasifikimi i bimëve të arave bëhet sipas grup kulturash (drithëra, perime, bimë industriale, foragjere, farëra vajore, patate, fasule) në fushë të hapur dhe serra, kulturë e parë dhe e dytë.

Klasifikimi i drufrutorëve bëhet sipas grupeve kryesore: pemët frutore, ullinj, agrume, vreshta dhe pjergulla për numrin e pemëve gjithsej, pemët në prodhim, prodhimin dhe rendimentin.

Sipërfaqja e kultivuar

Sipërfaqja e kultivuar korrespondon me sipërfaqen totale të mbjellë për prodhimin e një kulture bujqësore, specifike gjatë një viti kalendarik të dhënë. Sipërfaqja e kultivuar përfshin sipërfaqet e mbjella me kulturave të para dhe të dyta. Sipërfaqja e perimeve gjithsej përfaqësohet nga sipërfaqja e perimeve të njoma, të thata dhe bostanoreve. Nga kjo sipërfaqe përjashtohen sipërfaqet e dëmtuara nga dëmtues natyror (përmbytjet, zjarre etj).

Serrë

Serrë është ambienti i mbuluar me xham apo me mbulesë të lartë, (që lejon kalimin e personave apo mjeteve mekanike), të fiksuara apo të lëvizshme (xham ose plastikë e fortë ose fleksibël), ku bimët kultivohen gjatë gjithë periudhës apo për pjesën më të madhe të rritjes saj.

Pemët frutore

Pemët frutore përfaqësohen nga frutat farore (mollë, dardhë, ftua), Frutat bërthamore (kumbulla, qershi,

pjeshkë, kajsi), frutat subtropikale(fiq, hurma, shegë), frutat arnore (arra, gështenja, bajame dhe lajthi), dhe te tjera.

Sipërfaqja prodhuese

Sipërfaqja prodhuese e drufrutorëve është sipërfaqja potenciale prodhuese. Përfshihen sipërfaqet e pemëtoreve të reja, blloqet e drufrutorëve extensive dhe të degraduara.